

## **Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja zhvillon seminarin “Mbi planifikimin e auditimeve për vitin 2024”**

**06.11.2023**

Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja zhvilloi në datën 06.11.2023 në mjediset e KLSH-së, seminarin “Mbi planifikimin e auditimeve për vitin 2024”.

Hapja e seminarit u bë nga drejtori i këtij Departamenti, z. Ryisim Xhaja, i cili bëri një prezantim të shkurtër mbi Departamentin, si dhe u ndal në auditimet e kryera ndër vite, duke u fokusuar kryesisht në institucionet e audituara, rezultatet e arrituara, parregullsitë e konstatuara si dhe në problematikat e hasura gjatë punës audituese.

Më pas fjalën e mori z. Jonild Hoxhaj, në cilësinë e Kryeaudituesit të Departamentit, i cili foli mbi menaxhimin e burimeve, rekrutimet e reja të punonjësve të profileve të ndryshme, qëllimet dhe objektivat e auditimit si dhe në fund u bë një analizë SWOT e Departamentit.



Në vijim, z. Erald Kojku, auditues i parë i Departamentit bëri një përshkrim të faktorëve të riskut, si dhe tregoi fazat e planifikimit vjetor të auditimeve. Gjithashtu, z. Kojku foli edhe për indikatorët mbi përzgjedhjen e institucioneve që janë planifikuar për t’u audituar gjatë vitit 2024.

Në fund të takimit, fjalën e mori përsëri drejtori i Departamentit, z. Ryisim Xhaja, i cili bëri një përmbledhje të diskutimeve të seminarit si dhe të caktimit të subjekteve që anëtarët e Departamentit propozojnë që të auditohen në vitin 2024.